



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 04.07.2025

Më datë 4 Korrik u zhvillua takimi i radhës së Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave (KKN). Zj Elsa Dhuli, kryetare KKN i uroi mirëseardhjen anëtarëve të rinj dhe prezantoi axhendën e ditës:

1. Puna e kryer nga INSTAT në kuadër të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP);
2. Komentet e marra nga institucionet në lidhje me Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev 2.1) të rishikuar:
 - a. *Komentet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);*
 - b. *Komentet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, (MAS);*
 - c. *Komentet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM).*
3. 3. Prezantim informues mbi Klasifikimin e Produkteve sipas Aktiviteti Ekonomik, CPA

Prezantimin i rendit të ditës u miratua pa ndryshime nga anëtarët. Takimi vijoi sipas axhendës.

Puna e kryer nga INSTAT në kuadër të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)

Zj Anisa Omuri drejtoreshë në Drejtorinë e Statistika Sociale, INSTAT, bëri një prezantim informues mbi klasifikimin COICOP 2018. Ndër të tjera ajo theksoi që Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP) 2018, siguron një kuadër të përbashkët mbi klasifikimin e shpenzimeve të konsumit të Njesisë Ekonomike Familjare (NJEF), duke grupuar: produktet, mallrat dhe shërbimet sipas qëllimeve specifike, me frekuenca të ndryshme të mbledhjes së informacionit. Zbatimi i COICOP daton prej vitit 1923, duke u përmirësuar vazhdimisht për të adresuar ndryshimet në modelet e konsumit. COICOP 2018 është miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2018 dhe nga BE-ja në rregulloren ESA 2010. Fushat e zbatimit të COICOP janë: në Anketën e Buxhetit të NJEF; në përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit si dhe në llogaritjen e konsumit final të NJEF si një agregat i rëndësishëm i Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e shpenzimeve.

Deri tani nga INSTAT është përshtatur në versionin shqip COICOP 2018, nivel 5- shifror dhe është dërguar për komente pranë dy drejtorive kryesore përkatësisht Drejtoria e Llogarive Kombëtare si dhe Drejtoria e Sektorit Real. Pas reflektimit të komenteve nga këto dy drejtori,

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tiranë.
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

draft dokumenti do të dërgohet për komente ose sugjerime tek anëtarët e KKN (versionin anglisht si dhe versionin shqip).

INSTAT është mbështetur teknikisht në krijimin e infrastrukturës statistikore duke mundësuar lidhjen e COICOP 2012 me 2018. Njëkohësisht po punohet dhe për ridizajnimin e pyetësorit të Anketës së Buxhetit të NJEF në mënyrë përshtatjen me COICOP 2018.

Zj Dhuli theksoi që përkthimi është kryer nga ekspertët e INSTAT dhe komentet që do vijnë nga anëtarët e KKN-së janë shume të rëndësishme për të pasur një përshtatje sa më të mirë të klasifikimit në nivel kombëtar. Anëtarët do fokusohen kryesisht në fushën e tyre respektive.

Komentet e marra nga institucionet në lidhje me Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev 2.1) të rishikuar

Pas miratimit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të rishikuar, NVE Rev 2.1 në takimin e fundit të KKN-së për vitin 2024, praktika u dërgua në Kryeministri për të vijuar më tej me miratimin në Këshillin e Ministrave (KM). Nëpërmjet platformës e-aktet erdhën tre komente në lidhje me praktikën e NVE Rev 2.1. Ministritë që u shprehën ishin: Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) si dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Gjithashtu në lidhje projekt-vendimin, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) u shpreh për disa ndryshime të tjera.

Z. Maldy Dema, anëtar i KKN-së si dhe drejtor i Drejtorisë Juridike pranë INSTAT bëri një përshkrim të procedurës juridike që ndiqet nga KKN e deri në dërgimin e praktikës në KM. KKN është një komision i karakterit teknik, i diskuton definicionet dhe mënyrën e zbatimit në institucione, gjithashtu përgatit dhe një projekt-vendim për përputhshmërinë e këtyre standardeve. Projekt-vendimi shkon në KM nga ku vendoset hyrja në fuqi e klasifikimeve dhe publikimi në fletoren zyrtare. Ka ndodhur fenomeni që ky produkt (praktika e NVE Rev 2.1) është dërguar në KM dhe pasi KM kryen procedurat e tij (e dërgon për komente pranë Ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse), Ministritë dhe Institucionet përgjegjëse kanë dërguar sërish komente (MAS, MTM dhe AKSHI).

Z. Maldy vijoi më tej me sugjerimet e ardhura nga AKSHI. INSTAT ka propozuar që AKSHI do të asistojë teknikisht sipas kërkesave të institucioneve të administratës shtetërore projekt-vendimin e kodeve sipas nomenklaturës pjesë e këtij vendimi. Ndërkohë që AKSHI shprehet që bazuar në ligjin Për Qeverisjen Elektronike, AKSHI si krijues, zhvillues dhe administrues i sistemeve qeveritare, administron nga ana teknike çdo sistem që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e KM. Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve përbëhen nga bazat e të dhënave, mbeten nën administrimin e institucioneve respektive. Për sa më lartë AKSHI ka kërkuar që të hiqet kjo pikë nga projekt-vendimi. Duke qenë se janë krijuar vonesa me kërkesën e zbatim të Planit Kombëtar të Integritetit Evropian (PKIE) kërkesa e AKSHI u mor në konsideratë. Pasi të miratohet nomenklatura NVE Rev 2.1 të propozohet një projekt-vendim i ri në KM (pasi të jetë marrë

INSTITUTI I STATISTIKAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

një konfirmim paraprak nga AKSHI se çfarë akti i ri duhet nxjerrë për zbatimin e kësaj nomenklature).

Disa anëtarë u shprehën që AKSHI të jetë pjesë si anëtarë në KKN.

Zj. Dhuli theksoi që për procesin integritetit evropian që po kalojnë të gjithë institucionet, NVE Rev 2.1 është një nga kriteret të zbatimit të standardeve të BE, pra është kusht i domosdoshëm që jo vetëm INSTAT por dhe të gjithë institucionet në Shqipëri duhet të fillojnë zbatimin e nomenklaturës NVE Rev 2.1 (është kusht i integritetit).

Zj. Albana Berbiu, përgjegjëse në Sektorin e Analizave Sektoriale bëri një prezantim të sugjerimeve të ardhura nga MAS në lidhje me seksionin e Arsimit. Gjithsej janë tetë sugjerime të cilat u analizuan nga ekspertët në INSTAT dhe me definicionet që përdoren në ligjin e arsimit në fuqi. Në vijim Zj. Berbiu prezantoi komentet që janë marrë në konsideratë si dhe komentet të cilat nuk do merren në konsideratë dhe arsyen pse. Në bashkëpunim dhe me përfaqësuesen e MAS Zj. Ornela Koleka, prezantimi u krye në formën e bashkëbisedimit dhe u vendos që anëtares nga MAS t'i dërgohet seksioni Arsimit në versionin anglisht dhe shqip.

Komentet e ardhura nga MTM pasi u analizuan nga ekspertët e INSTAT u morën parasysh. Pasi të pasqyrohen komentet e Ministrive, dokumenti i finalizuar do ju dërgohet anëtarëve.

Prezantim informues mbi Klasifikimin e Produkteve sipas Aktiviteti Ekonomik, CPA

Takimi vijoi me një prezantim informues mbi Klasifikimin e Produkteve sipas Aktivitetit Ekonomik të rishikuar, CPA 2.2. Zj. Alma Mara, drejtoreshë në Drejtorinë e Sektorit Real ndër të tjera theksoi që ky klasifikim bazohet në NVE Rev 2.1, klasifikon mallrat dhe shërbimet si dhe përdoret për prodhimin e statistikave zyrtare. Rishikimi i CPA vjen si nevojë e reflektimit të zhvillimeve ekonomike, teknologjike dhe shoqërore. Aktualisht EUROSTAT është duke përfunduar rishikimin e fundit të CPA e cila duhet të hyjë në zbatim për llogaritjen e statistikave gjatë vitit 2025.

Detyrat e lëna nga KKN:

1. Të përgatisë minutat e takimit - *Sekretariati i KKN*
2. Të miratojë minutat e takimit - *Anëtarët e KKN*;
3. Finalizimi i projekt-vendimit sipas ndryshimeve të kërkuara nga AKSHI - *Anëtarët e KKN*;
4. Finalizimi i dokumentit NVE Rev 2.1 sipas ndryshimeve të kërkuara nga MAS dhe MTM – *Anëtarët e KKN*;
5. Draft COICOP 2018 – *Afati për komente 30.09.2025*

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tiranë.
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Lista e anëtarëve pjesëmarrës, takimi 04 Korrik 2025

Nr.	Emri i Institucioni	Anëtarët	KKN
1	INSTAT	Elsa Dhuli	Kryetar
2	INSTAT	Maldi Dema	Anëtar
3	INSTAT	Flutura Rama	Anëtar
4	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Aida Meçe	Anëtar
5	Ministria e Brendshme	Ardian Biti	Anëtar
6	Ministria e Financave	Eva Kuqi (Doda)	Anëtar
7	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Antonio Bushati	Anëtar
8	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Ornela Koleka	Anëtar
9	Ministria e Drejtësisë	Besnik Cina	Anëtar
10	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Mitea Gegushi	Anëtar
11	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Entela Buzali	Anëtar
12	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	Edlira Krekas	Anëtar

Përgatiti:

Sekretariati i KKN

07 Korrik 2025